



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.12/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës I.C.S, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 02.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarës I.C.S, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 14.11.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarës I.C.S, me arsyetimin se gjyqtarja ka bërë shkelje ligjore dhe manipulon rastin me prokurorinë, qesh fshehtë në seancë, ka kërkuar që urgjentë ta tërheq lëndën nga gjyqtarja pasi që e njëjta ka bërë shkelje në çdo seancë për faktin se në vazhdimësi janë ndërruar prokurorët në këtë lëndë.

Tutje në këtë ankesë parafrazohet emrin i një gjyqtarit tjetër të kësaj gjykatë për një lëndë kontestimore, pasi që për pretendimet e parashtruesit lidhur me këtë gjyqtar është duke u zhvilluar procedura disiplinore e veçantë, të njëjtat pretendime do të theksohen dhe trajtohen në lëndën përkatëse.

Me datë 14.11.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarës I.C.S.

Gjyqtarja I.C.S, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se ankesa është e pakuptueshme, e paqartë se për kënd është parashtruar ankesa dhe për cilën çështje është parashtruar, e njëjta thekson se nuk është hera e parë që parashtron “ankesë-kërkesë”, dhe ka bashkëngjitur deklaratës një kërkesë të parashtruesit. Tutje thekson se i njëjti ishte ankuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës lidhur me mos caktimin e seancës,

mirëpo gjykata ka njoftuar kryetarin se seanca ishte e caktuar dhe mungonte i dëmtuari këtu parashtruesi I.K, e lidhur me këtë ekziston njoftimi i kryetarit GJ.A.nr.244/24. Tutje në deklarinimin e saj thekson se sa i përket lëndës të cilën e ka gjykuar, ku parashtruesi i ankesës është palë e dëmtuar, i njëjti nuk e kishte sjelljen e duhur dhe vazhdimisht dëshironte të bënte pyetje lidhur me çështjen civile të cilën e kishte në procedurë, mirëpo gjykata pyetjet lidhur me pronën dhe shtëpinë të cilën e përmendte nuk ia lejonte, pasi procedura penale zhvillohet për veprën penale kanosje, nga neni 181 par.1 të KPRK-së. Ka njoftuar se lënda penale ka përfunduar me tërheqjen e prokurorit të shtetit nga ndjekja penale në fjalën përfundimtare për shkak të mungesës së provave. Thekson se sa i përket mbajtjes së seancave gjyqësore, ka bashkëngjitur të gjitha procesverbalet e seancave nga të cilat mund të konstatohet mbajtja dhe udhëheqja e seancave dhe shkeljeve eventuale.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarës I.C.S, së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Pretendimi se gjyqtarja ka bërë shkelje ligjore dhe manipulon rastin me prokurorinë, këto pretendime nuk janë mbështetë me asnjë provë dhe nuk janë argumentuar në asnjë mënyrë nga ana e parashtruesit të ankesës, lidhur me pretendimin se gjyqtarja qesh fshehtë në seancë, i njëjti pretendim nuk është argumentuar nga parashtruesi i ankesës, e duke u mbështetur edhe mbi faktin që procesverbalet e seancave janë të nënshkruar pa vërejtje, autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore dhe gjeti se pretendimet në fjalë janë të paargumentuara me asnjë provë dhe shumë të përgjithësuara dhe si të tilla mbeten vetëm supozime të palës ankuese.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit se “gjyqtarja ka bërë shkelje në çdo seancë për faktin se në vazhdimësi janë ndërruar prokurorët në këtë lëndë”, ky pretendim është i pabazuar për faktin se është çështje organizative e prokurorisë përfaqësimi i aktakuzave në gjykatë, andaj mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtarja ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.12/24, me datë 02.12.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarës I.C.S*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.K, nga fshati Q..., K... e P...*